



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 22
Prishtinë, më 04.05.2018, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Aida Dërguti, Visar Ymeri, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Elmi Reçica, Evgjëni Thaçi-Dragusha, Sërgjan Mitroviq dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Danush Ademi.

Pjesëmarrësit e tjerë: Valmir Haziraj, Kaltrina Statovci, Agnesa Hasani, Alban Bajrami, Egnesa Vitia –praktikantë, Violeta Haxholli, Egzon Osmanaj-KDI, Vlora Nushi-OPA/UNMIK, Adem Gashi-US Embassy, Gurjeta Zeka –GDP, Blerta Bejtullahu-EU/EUSK dhe media.

Nga zyra e komisionit: Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i Projekt- Platformës shtetërore për finalizimin e dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy shteteve.

Vjosa Osmani-Sadriu lidhur me shqyrtimin e Projekt- Platformës shtetërore për finalizimin e dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy shteteve, tha se i është proceduar komisionit, që në cilësi të komisionit funksional që ta shqyrtojë dhe t’ja paraqesë Kuvendit raportin me rekomandime lidhur me të.

Dukagjin Gorani tha se ky dokument i shkurtër është në frymën e dokumenteve të tjera të ngjashme që përpiqet ta vë Kuvendin në pozitë të nënshtruar. Nga 9-të pikat e propozuara në të, 4-5 pikat e para janë konstatime tërësisht arbitrare, ndërsa 5 pikat e tjera janë imponime ndaj Kuvendit. Pika e 6 tha se është absolutisht e dëmshme dhe e bie Kuvendin në pozitë të një vulosësi dhe të një subjekti të nënshtruar. Kjo draft-platformë me këtë përmbajtje tha se është vështirë të cilësohet si e tillë dhe se nuk mund ta ketë përkrahjen e Grupit të deputetëve të pavarur.

Evgjëni Thaçi-Dragusha duke u ndërlidhur me parafolësin, e pyeti atë se ku e shef rolin subordinues të Kuvendit në këtë dokument. GP i PDK-së tha se do ta mbështesë këtë platformë dhe vullnetin e kryeministrit për njohjen e rolit të Kuvendit në këtë proces. Draft-platforma tha se përmban pika

gjithëpërfshirëse të cilat mund të plotësohen dhe në fund të dalim me një marrëveshje ligjore, për njohje reciproke në mes të dy vendeve.

Dukagjin Gorani theksoi se pika 6-të e draft-platformës konkludon që Presidenti autorizohet të zhvilloj bisedime, që e sjell Kuvendin para aktit të kryer.

Visar Ymeri tha se shihet se në këtë draft-platformë vendimet janë marrë dhe se kërkohet nga ne që ato t'i miratojmë. Një platformë e tillë do të duhej të ishte konkludim i dialogut, e jo nisje e dialogut. Në pikën e parë të draft-platformës përmes së cilës parashihet të ndodh njohja reciproke, nuk parashihet si do të arrihet ajo, çka nëse nuk arrihet, a e pranojmë ne atë marrëveshje, e as për ndonjë masë mbrojtëse për ta parandaluar shkeljen e Kushtetutës. Ai në vazhdim tha se në këtë draft-platformë nuk ka ndonjë ndryshim në përdorimin e diskursit dhe terminologjisë politike, që në vend të parashikimit të zbatimit të masave të reciprocitetit të fqinjësisë së mirë, terminologjia e përdorur e bën kërkesën tonë për njohje nga Serbia pak si të dyshimtë. Z. Ymeri theksoi se në Kuvendin e Kosovës është i nevojshëm një debat i mirëfilltë, gjithëpërfshirës lidhur me dialogun, i cili nuk mund të bëhet pa u akorduar për të kaluarën. Është e çuditshme shtoi ai se, si vazhdojmë të kemi forca politike të cilat e konsiderojnë marrëveshjen e vitit 2015 plotësisht në rregull, përkundër aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese. Me këtë qasje karshi dialogut, tha se rrezikojmë të humbim shumë në këtë pjesë që ka mbetur karshi dialogut dhe të formojmë platformë shtetërore. Ai propozoi që lidhur me draft-platformën komisioni të rekomandojë që të mbahet një diskutim për dialogun në Kuvend, ku nuk do të kishte dokumente por do të prodhoheshin ato.

Zafir Berisha për dokumentin e draft-platformës, tha se ai nuk e qartëson, e as nuk i jep kuptim këtij procesi. Ky dokument tha se është një radhitje fjalësh me tejkalim të përgjegjësive kushtetuese. Kuvendi në bazë të Rezolutës së tij të miratuar më parë i bartë përgjegjësitë e bisedimeve fillimisht teknike e pastaj edhe politike te qeveria, ndërsa tani sipas pikës 6-të të këtij dokumentit tentohet të barten kompetencat te Presidenti që mes të tjerash bie ndesh edhe me të kaluarën, në këtë proces me Serbinë. Ai tha se kemi marrëveshje kundër kushtetuese dhe kundërligjore nga Presidenti aktual dhe fuqizimi i kësaj edhe më tej duke pasur parasysh të kaluarën, Kosovën e dërgon drejt një shteti jofunksional. Z. Berisha më tej njoftoi për dyshimet e tija të cilat i sheh në një trekëndësh të cilat e bëjnë që të mos qëndrojnë për këtë platformë, që e bëjnë Kosovën të del e dëmtuar nga këto bisedime. Ai theksoi se nëse ne mendojmë që Kosovën ta bëjmë si Bosnjën, atëherë është momenti që këtë ta stopojmë. Propozoi që draft-platforma t'i kthehet qeverisë e cila duhet të gjej modalitetin për të debatuar seriozitetin e çështjes në pozicione të barabarta si shtete, sepse e kaluara e afërt ka treguar se Kosova është trajtuar si provincë e Serbisë.

Time Kadrijaj theksoi se gjendemi në një situatë të ndjeshme e cila kërkon një unitet politik. Dokumenti i cili është përcjellë nga Qeveria tha se tregon se Qeveria po kërkon një bashkëpunim dhe transparencë. Znj. Kadrijaj lidhur me draft-platformën tha se është e nevojshme që të gjithë të japin kontributin sepse gjendemi në një fazë të ndjeshme dhe cilido kontribut i Kuvendit, i partive politike, pa marrë parasysh a janë pozitë apo opozitë është i nevojshëm për plotësimin e këtij dokumenti dhe dhënies së dritës jeshile për kalimin e tij.

Elmi Reçica shqyrtimi i draft-platformës shtetërore të dialogut tha se është një ndër çështjet më të rëndësishme gjatë kësaj kohe, e cila ka të bëjë me përmbylljen e bisedimeve me Serbinë. Ai theksoi se duke u nisur nga fakti se bisedimet kanë filluar nga Grupi i unitetit, duke u nisur nga Presidenti, është ide e mirë që ato të përmbyllen si të tilla. Sipas Kushtetutës së Kosovës tha se Presidenti pos rolit ceremonial përfaqëson edhe rolin e shtetit dhe në këtë drejtim pavarësisht kush ka qenë dhe kush është tani, e mbështesin presidentin që të jetë në krye të ekipit për të përmbyllë bisedimet. Z. Reçica në mes tjerash tha se është e rëndësishme që asnjë marrëveshje ndërkombëtare nuk mund të jetë e përmbyllur

nëse nuk ratifikohet në Kuvend me 2/3 e votave dhe se draft-platforma është një bazë e mirë për shqyrtim dhe plotësim, në interes shtetëror.

Doruntinë Maloku Kastrati lidhur me draft- platformën e qeverisë tha se ky dokument nuk mund të quhet platformë, për një proces të përmbylljes së dialogut me Serbinë. GP-LDK-së e ka potencuar disa herë se ky dokument ka tepër mangësi dhe nuk trajton asnjë nga temat që kanë rëndësi esenciale edhe për popullin e Kosovës edhe për shtetin e Kosovës, siç është kërkim falja nga Serbia për popullin e Kosovës, kompensimi i dëmeve të luftës, ndriçimi i fatit të të pagjeturve e për shumë çështje të tjera. Propozoi që në seancë plenare të propozohen rekomandimet për këtë draft-platformë në mënyrë që ta meritoj titullin platformë shtetërore.

Visar Ymeri theksoi se për të pasur një platformë për dialogun duhet të theksohet se si duhet të arrihet ajo, se cilën Kosovë presim ta njeh Serbia, që debati të fillojë prej asaj se ku kemi arritur deri tani me këtë dialog dhe për dështimet, se kjo marrëveshje e dytë e radhës a do ta marrë parasysh të parën. Duhet së pari të diskutojmë se çfarë dialogu na duhet, cilat janë vijat e kuqe të Republikës së Kosovës, jo vetëm karshi qëndrimeve tona, por edhe karshi temave të diskutimit.

Elmi Reçica tha se ne jemi duke diskutuar që draft-platforma shtetërore për bisedime të plotësohet, të begatohet dhe të lëvizim drejt përmbylljes së dialogut me Serbinë. Udhëheqësit e dialogut tha se nuk mund të marrin vendime që janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe se edhe më parë lidhur me çështjet e dialogut, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë respektuar. Përkrahë propozimin që draft-platforma për dialogun të diskutohet në seancë plenare dhe të plotësohet e ndryshohet me rekomandime të tjera, në harmoni me Rregulloren e Kuvendit.

Dukagjin Gorani lidhur me analizën për dialogun të përgatitur nga KDI tha se është një punë shumë më e madhe se draft -platforma e qeverisë dhe se do të ishte mirë që këto parime të integrohen tërësisht në platformën shtetërore.

Zafir Berisha tha se nuk jemi që të mos kemi unitet në mes të forcave politike për zgjidhjen e problemit historik me Serbinë, por kjo platformë nuk e trajton seriozitetin e çështjes. Të futemi kaq lehtësisht në bisedime përfundimtare me Serbinë tha se dyshoj që e vulosim fatin e një shteti jofunksional, prandaj çështja duhet të diskutohet pak më ndryshe. Z. Berisha tha se nuk do të jetë për një dokument të kësaj natyre, pavarësisht se mund të debatohet në Kuvend si organi më i lartë i shtetit.

Time Kadrijaj pos tjerash propozoi që draft- platformës t'i shtohet edhe një pikë, që marrëveshja para se të nënshkruhet prej liderëve të diskutohet në Kuvend se a është në përputhje me legjislacionin.

Aida Dërguti tha se draft-platforma është shumë sipërfaqësore ku janë të shprehura dëshirat tona të shumta për integritet të ndryshme dhe përmbyllet me pjesën se kush do të jetë i autorizuar për bartjen e përgjegjësisë për dialog. Më tej tha se Presidenti i Serbisë është zgjedhur me vota të drejtpërdrejta, ndërsa Presidenti i Kosovës është zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës dhe e dimë se nuk e përfaqëson unitetin, sa i përket mënyrës se si është zgjedhur. Rreth platformës tha se është i nevojshëm konsensusi politik, ndërsa kjo draft-platformë nuk paraqet platformë në çështje konkrete dhe të detajuara. Për ta autorizuar Presidentin e Kosovës, që të jetë bartës i procesit të negociatave në këtë fazë tha se nevojiten 2/3 e anëtarëve të Kuvendit. Përkrah propozimin e Z. Ymerit që draft-platforma të diskutohet në seancë plenare dhe të propozohen rekomandime përmbytësore në seancë.

Vjosa Osmani- Sadriu theksoi se si LDK, qëndrimi ynë ka qenë se dialogu nuk ka alternativë tjetër. Ky proces tha se nuk duhet të stopohet por si përfaqësues të popullit duhet të mësojmë nga gabimet së kaluarës se asnjë qeveri me numër të vogël nuk mund të ketë sukses në një proces kaq kompleks, me një shtet si Serbia, nëse nuk krijohet një unitet në vepër. Ajo tha se ka pritur që platforma të jetë një rezultat i një debati të gjerë gjithëpërfshirës që do të dëgjojë zërat e të gjithëve pa paragjykitime, ku

secili nga ne duhet ta kuptojë që, jo kundërshtimet me njëri- tjetrin, por një Kosovë e fuqishme në raport me Serbinë është ajo që duhet ta ndërtojmë. Kjo platformë tha se është e kundërta e një pritjeje të tillë, sepse nuk ka pasur debat në Kuvend që do të prodhonte një rezolutë të tillë. Znj. Osmani-Sadriu theksoi se çështja e të pagjeturve e cila ishte prioritet i Rezolutës së Kuvendit para një jave, tani është injoruar në këtë draft-platformë dhe shumë çështje të tjera që janë parakusht në normalizim të raporteve. Marrëveshja duhet të ketë parasysh integritetin territorial dhe sovranitetin e shtetit, mirëpo askund nuk përmendet se marrëveshja duhet të jetë në përputhshmëri me Kushtetutën e Kosovës dhe askund nuk thuhet që rregullimi i brendshëm i Republikës së Kosovës, nuk do të negociohet. Kjo lë hapësirë që çështjet e funksionalitetit të brendshëm të shtetit të jenë objekt negociatash rrjedhimisht objekt kompromisi. Duke u ndërlidhur me pikën 6 të draft-platformës lidhur me rolin kushtetues të institucionit të Presidentit në udhëheqje të dialogut tha se përkundër faktit se me Kushtetutë të Kosovës institucioni i Presidentit identifikohet si përfaqësues i vendit brenda dhe jashtë, komentari zyrtar i Kushtetutës së Republikës së Kosovës e sqaron se, kjo është kompetencë formale pa substancë diskrecioni në vendim marrje për të negociuar me shtet e huaja dhe se nuk duhet nënkuptuar si kompetencë për të krijuar pozicion të cilin Kosova duhet ta mbajë në marrëdhënien e saj me botën e jashtme. Sa i përket çështjes së dërgimit të marrëveshjes në Gjykatën Kushtetuese, Znj. Osmani-Sadriu tha se Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencë për të vlerësuar substancën e marrëveshjes, por vetëm procedurën përmes së cilës është miratuar marrëveshja. Ndërsa sa i përket themelimit të Asociacionit, tha se ka qenë një situatë tjetër nga se është klasifikuar si dokument ndërmjetëm dhe i brendshëm i Kosovës. Ajo konfirmoi se LDK e përkrahë procesin e dialogut vetëm përmes një platforme e cila definojnë qartë kompetencat dhe temat, që mbron sovranitetin dhe kushtetutshmërinë dhe se do ta paraqesin në Kuvend opsionin se cila është platforma përmes së cilës shteti i Kosovës do të dalë më i fortë në raport me Serbinë.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë

Përfundim

1. I rekomandohet Kuvendit të mos miratojë Platformën shtetërore për finalizimin e dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy vendeve, në përmbajtjen e propozuar nga Qeveria.(3 vota për dhe 6 vota kundër miratimit të draft-platformës)
2. I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të organizojë debat parlamentar nga i cili do të dalin rekomandimet për ndërtimin e platformës konsensuale shtetërore të Republikës së Kosovës për dialogun Kosovë-Serbi. (shumicë votash)

Mbledhja përfundoi në orën 15:40.

Kryetarja e komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.